



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 20 Janar 2020

### Komunikatë

PZAP-i paralajmëron subjektet politike për pagesën e gjobave të papaguara të zgjedhjeve të 06 tetorit 2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, ka njoftuar/paralajmëruar subjektet politike që brenda 15 ditëve kalendarike duke filluar nga data 17 Janar deri me 31 Janar 2020, të paguajnë gjobat e shqiptuara nga PZAP-i ndaj tyre për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 06 tetorit 2019, në të kundërtën PZAP-i do të jetë i detyruar që të zbatoj ligjin e aplikueshëm, **respektivisht do të shqipton dënime shtesë për secilin vendim veç e veç**, si dhe do të zbatoj ligjin e aplikueshëm të procedurës përmbartimore nr. 04/L-139

*Neni 120, paragrafi 2. të LZP-së, përcakton se dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.*

PZAP-i, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 06 tetorit 2019, ka shqiptuar gjoba ndaj subjekteve politike dhe atë:

1. Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK = 74,850.00 euro, **Nuk ka paguar**
  2. Partia Demokratike e Kosovës – PDK = 100,100.00 euro,  
**Ka paguar 45,000.00 euro**  
**Nuk ka paguar 55,100.00 euro,**
  3. Lëvizja Vetëvendosje = 14,100.00 euro, **Nuk ka paguar**
  4. Lista Serbe = 36,500.00 euro, **Ka paguar**
  5. Koalicioni AAK-PSD = 89,600.00 euro, **Nuk ka paguar**
  6. Koalicioni Nisma- AKR- PD = 33,900.00 euro, **Nuk ka paguar**
  7. PREBK = 250.00 euro, **Nuk ka paguar**
  8. IRDK Lendrit Qeli = 1,200.00 euro, **Ka paguar**
  9. Koalicioni Sloboda = 5,100.00 euro, **Nuk ka paguar**
  10. PLE = 1,100.00 euro, **Ka paguar**
  11. VAKAT = 1,100.00 euro, **Nuk ka paguar**
  12. KDTP = 1,100.00 euro, **Nuk ka paguar**
  13. PG = 1,100.00 euro. **Ka paguar**
- Gjithsejtë gjoba: = 360,000.00 euro**

**Gjoha të paguara: = 84,900.00 euro**

**Gjoha të papaguara: = 275,100.00 euro**

**Te dhënat e PZAP-it janë te datës 17 janar 2020**